



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 16

Datë: 11. 03. 2020. Ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Ylli Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.14/2020;

**2. Aktivitetet e ZRPP-së:**

- Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim e grupit të katërt të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës;

**3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

**• Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve të anëtarëve të KVV-ve për Ekipet Mobile për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës ;
- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Opeacional për ditën e zgjedhjeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurës për raportimin e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe rezultateve preliminare për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës;

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.
- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpenzimet e telefonisë mobile për anëtarët, stafin e KQZ dhe menaxherët e Qendrave të Vendvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren;

- **Këshilli i Personelit:**

- Informatë në lidhje me pozitat e lira në Sekretariatin e KQZ-së;

## **5. Të ndryshme.**

---

### **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

**Valdete Daka:** E hapim këtë mbledhje, a ka dikush vërejtje...? Nëse jo, kush është për këtë rend dite...? Aprovohet, faleminderit... Pas aprovimit të rendit të ditës, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nga mbledhja nr.14/2020 e KQZ-së.

### **2. Aktivitetet e ZRPP-së:**

Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim e grupit të katërt të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës.

**YII Buleshkaj:** Të nderuar, afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve të partive politike të certifikuara, ka përfunduar dje në ora 18:00. Para jush, e paraqesim listën për t'i akredituar të 877 vëzhguesve, ndërsa në total, janë: 1487 vëzhgues. Organizatat e huaja dhe mediat, kanë afat ende të aplikojnë...Procesi ka rrjedh mirë, dhe ne rekomandojmë akreditimin...

**Arianit Elshani:** Po e shoh që PDK ka 321 vëzhgues, LDK ka 5 vëzhgues, LVV 352... Më intereson numri i saktë i secilës parti...!

**Ylli Buleshkaj:** Të LDK-së janë kryer në mbledhjen e kaluar, dhe ky është numri shtesë. Legjislacioni, nuk e kufizon numrin e vëzhguesve, prandaj secili subjekt mund të ketë vëzhgues aq sa e sheh të nevojshme – të mundur... Janë gjithsej 115 vendvotime, dhe subjektit mund të kenë me mijëra vëzhgues...

**Valdete Daka:** Pra, kush është për akreditimin e këtyre vëzhguesve...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së për akreditim e grupit të katërt të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës.

### **3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**Ylli Buleshkaj:** Fletëvotimet kan arritur sot dhe janë në depon e KQZ-së, pra, kanë arritur me kohë. Formularët janë shtypur dje, dhe janë verifikuar të gjithë: 450 formularët.. Trajnim, po ashtu është në rregull...

Gjithashtu, janë regjistruar personat me nevoja të veçanta: janë 87 persona të ngjujar në shtëpi, 21 janë nëpër institucione, 11 janë në burgje, dhe 10 janë në spitale... Janë 6 ekipe që do merren me këta persona..

Po ashtu, QNR është në përfundim të përgatitjeve, si dhe kontratat që janë paraparë me operatorët ekonomik janë realizuar dhe nuk presim probleme me shërbimet...

**Alim Rama:** Deri të shtunën, besoj që ti kemi materialet...

### **4.Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

#### **1.Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve të anëtarëve të KVV-ve për Ekipet Mobile për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.**

**Alim Rama:** KOZ, sot në bazë të kërkesës së Sekretariatit ka shqyrtuar dhe ka nominuar anëtarët e ekipeve mobile. Sekretariati ka rekomanduar me pas 6 ekipe mobile, të cilët Këshilli i ka shqyrtua dhe në mënyrë unanime rekomandon KQZ-së për aprovim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Opeacional për ditën e zgjedhjeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.

**Alim Rama:** Sot, KOZ ka shqyrtuar edhe Planin Opeacional për ditën e zgjedhjeve të përpiluar nga Sekretariati. KOZ, pas shqyrtimit, i rekomandon KQZ-së për aprovim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurës për raportimin e pjesëmarries në zgjedhje dhe rezultateve preliminare për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.

**Alim Rama:** Po ashtu, KOZ ka shqyrtuar edhe procedurën për raportimin e pjesëmarries në zgjedhje dhe të rezultateve preliminare. Këto procedura, siç janë rekomanduar nga Sekretariati, KOZ-i i ka miratuar, dhe i rekomandon KQZ-së për miratim.

**Eshref Vishi:** Këtu, e keni veshur me përgjegjësi menaxherin e QV-së, ndoshta është në funksion të detyrave që merr, por në të ardhmen mbetet që të shikohet përgjegjësia e tij. Pra, të shihet se cili është roli i tij ligjor në ditën e zgjedhjeve. Kësaj here le të shkojë kështu, por unë kam shumë rezerva... Por, kam pyetje: Kur është fjala tek menaxherët, a mendoni se për 5 apo 10 minuta, ky do ti merr rezultatet, do t'i kryej detyrat e veta në QV, apo prezenca e tij është "on linë", brenda ditës...?

**Ylli Buleshkaj:** Stafi i KV-e, trajnohet që në kohë të caktuar t'i përgatisin numrat, për shembull te "raportimi i daljes". Në qoftë se, raportimi është në ora 11:00, ata e dinë që "5 minuta në 11", ata e dinë që duhet ta kenë të gatshëm numrin se sa votues kanë votuar...! Kryesuesit, e dinë kohën, e kanë në doracakë të shkruar...

Ne, kemi bërë vlerësimin, sidomos për kosoton e shpenzimeve...Këto janë zgjedhje vetëm në një komunë, dhe e kemi pasur më lehtë të operojmë... zyrtarët tanë të premten shkojnë në Podujevë ta bëjnë trajnimin..

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ.

**2.Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

1.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.

**Sami Hamiti:** Sot, jemi takue dhe kemi shqyrtuar pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV) për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës. Është një vendim i cili, është konform kuotës buxhetore. Buxhet kemi,

por ekziston edhe një vendim formal, porse edhe nga auditori është kërkuar që pavarësisht që ke pozicionin buxhetor, të ketë edhe një vendim për ndarje. Ndarja, konsideroj që është në bazë të vendimeve të mëhershme, dhe KB i rekomandon KQZ-së që ta votoj si të tillë.

**Eshref Vishi:** A është fjala për vendimin e pagesës së stafit të angazhuar...? Atëherë, unë kam një vërejtje që, ndërlidhet me pikën 6, tek pagesa e anëtarëve rezervë të KV-e e cila, është e përcaktuar me shumën 22.50 euro në ditë. Kur dihet se anëtarët rezervë janë të njëjtë më anëtarët e rregullt, pra vijonë trajnimet normalisht, dhe ditën e zgjedhjeve ata duhet të jenë në dispozicion, eventualisht nëse kërkohet të zëvendësohen brenda ditës së zgjedhjeve, pra po e ngris si çështje: pse është paraparë që të jenë të angazhuar 2 ditë dhe jo 3 ditë, dhe pse edhe shuma e pagesës është më e ulët...?

**Ylli Buleshkaj:** Duket që është jashtë normales, por kjo është pagesa për anëtarët që nuk angazhohen, por nëse jo, kjo është pagesa. Pra, personat rezervë nuk do të jenë tërë kohën të angazhuar, ata deri në orën 10 nëse nuk angazhohen, ata janë më të lirë. Pra, stafi rezervë është alternativë për çdo rast...Ata trajnohen 1 ditë...

Në debat, morën pjesë: Sami Hamiti, Arianit Elshani, Valdete Daka.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

**2.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpenzimet e telefonisë mobile për anëtarët, stafin e KQZ dhe menaxherët e Qendrave të Vendvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës.**

**Sami Hamiti:** Pikë tjetër që e kemi shqyrtuar ka qenë: miratimi i vendimit për shpenzimet e telefonisë mobile për anëtarët, stafin e KQZ dhe menaxherët e Qendrave të Vendvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës. Unanimisht jemi pajtuar për menaxherët e QV-e, të paguhen mjetet. Ka pasur mendime të kundërtat rreth pjesës tjetër, anëtarëve të KQZ-së dhe Sekretariatit për shtesat. Është shpjeguar që, do të jetë 50% të mbushjeve, ndryshtë nga praktika e kaluar meqë, është një komunë e vogël...

**Ylli Buleshkaj:** Kemi pasur divergjencia edhe në menaxhment, por edhe ne kemi ardhur në përfundim që të jetë 50%, dhe jo qind për qind... Kemi shërbime ku duhet bërë shumë telefonata, komunikime...! Jemi munduar të bëjmë një balancim, një zgjidhje të drejtë, dhe mendojmë që nuk është një shumë e madhe, si total është 664 euro për shërbime...

**Alim Rama:** Unë, shkurt: ndoshta jo secili i shpenzon këto, por këto shpenzime parashihen. Por, në bazë të përllogaritjeve dhe çmimeve në treg, se kjo është dyfishi i shpenzimeve, dhe këto shpenzime nuk mund të arsyetohen... !

**Sami Kurteshi:** Telefonia mobile, është propozuar për këto zgjedhje, por ne duhet ta diskutojmë. Unë i marrë 50 euro mbushje si anëtar i KQZ-së, dhe nuk e di pse i marrë...! Këto janë mjete publike, dhe unë mendoj se askush nuk shpenzon më shumë se 10 euro ! Çmimet

kanë ndryshuar, dhe unë mendoj se qysh kur është nxjerrë udhëzimi administrativ në 2008 kur 1 minute ishte 36 cent, sot 1 minutë është 4 cent. Prandaj, ne duhet të mendojmë si t'i zgresim shërbimet...! Mendoj se ky është keqpërdorim...

**Arianit Elshani:** Pajtohem deri diku mbi shumat e cekura...! Unë e bëra një përllogaritje, dhe nëse mendojmë se shuma është e madhe për anëtarë të KQZ-së, atëherë në rregull, i heqim shtesat dhe si anëtarë të KQZ-së kursejmë 275 euro, dhe nga stafi tjeter i Sekretariatit: 649 euro..! Por, duhet kuptuar rolin dhe rëndësinë e këtij institucioni. Të kemi parasysh se, në cilin institucion jemi të angazhuar. Nuk jemi në asistencë këtu, dhe nuk duhet rrezikojmë. Të kemi parasysh rolin, ta zëmë për 5 euro një menaxher i QV-së të gjendet në vështirësi, për mua është e pa pranueshme dhe kjo shkakton de legitimit të procesit...

**Sami Kurteshi:** Për kënd është rritja...?

**Valdete Daka:** Kur janë zgjedhjet, ka shpenzime të jashtëzakonshme. Po, është një udhëzim administrativ në fuqi, dhe s'është vetëm për ne. Ne, e kemi zbatuar dhe do ta zbatojmë. Nëse ndryshon, ne prapë do ta zbatojmë ashtu si ndryshohet...

Në diskutim rreth kësaj pike, morën pjesë edhe: Sami Kurteshi, Yll Buleshkaj, Arianit Elshani, Eshref Vishi, Sami Hamiti, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, dhe Valdete Daka.

Anëtarët e KQZ-së, e votuan këtë rekomandim me 8 vota për, 2 kundër, dhe 1 abstenim.

### **3.Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren

**Arianit Elshani:** Këshilli, ka shqyrtuar kérkesën e Kuvendit Komunal të Prizrenit për zëvendësimin e anëtares së KK të Prizrenit nga radhët e KDTP-së, dhe pasi kjo kérkesë ka kaluar të gjithë filtrat procedural, këshilli rekomandon për zëvendësim.

**Valdete Daka:** Kush është që znj. Serdan Kervan, nga subjekti politik KDTP, të emërohet anëtarë e KK të Prizrenit, duke e zëvendësuar anëtaren e deritashme, znj. Xhenet Sajhadi – Zubani... ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim

### **4.Këshilli i Personelit:**

Informatë në lidhje me pozitat e lira në Sekretariatin e KQZ-së.

**Nenad Rikallo:** Këshilli i Personelit, në takimin e tij ka shqyrtuar informatën lidhur me vendet e lira të punës në Sekretariatin e KQZ-së, si dhe informatën lidhur me atë se buxheti i viti 2020 për numri i vendeve të punës, nga 88%, është zvogëluar në 82%. Sekretariati, na e ka dhënë informacionin për konkursset tashmë të shpallura, dhe ato në procedurë. Ne në këshill, kemi diskutuar se s'i ti realizojmë këto çështjet. Gjykoj që kryeshefi mund të na japë më shumë detaje, dhe ne t'i diskutojmë çështjet këtu në mbledhje së bashku...

**Ylli Buleshkaj:** Siç u fol, kemi pasur një prezantim lidhur me pozitat që janë të lira, si dhe rrith qarkores buxhetore. Disa pozita, siç dihet janë shkurtuar. Momentalisht, i kemi të pa plotësuara 10 pozita. Ministria e Financave, ka vendosë që të gjitha pozitat që nuk kanë qenë të plotësuara, t'i shkurtojë. Në takimin që kam pasur unë me MEF, janë shkurtuar 2600 pozita, dhe kjo na ka prekur edhe ne në KQZ. Ne, përmes një shkresë, e kemi njoftuar MEF-in për nevojën që këto pozita ti kemi, sepse nuk kemi pozita të dyfishta. Ende nuk kemi informacion se, çka është vendosur mirëpo, ministri ka thënë se nëse pozitat janë të arsyetuara mirë, ato do të kthehen!

Ne si Sekretariat, do të komunikojmë me Kuvendin që, të na kthehen të gjitha pozitat që i kemi pasur. Momentalisht, jemi në procedurë të rekrutimit të 4 pozitave, por shpresojmë që t'i kemi të gjitha pozitat. Ne, do t'ju mbajmë të informuar vazhdimesh...

**Valdete Daka:** Është për keqardhje që na janë shkurtuar këto pozita, por ato për vite me radhë edhe nuk u shpallen, sidomos me refuzimin dhe kryeneçesinë e ish krye shefit...! Pra, tash për tash i kemi humbur, por shpresojmë që do të na kthehen. Na duhet të kalojmë prapë nëpër procedura të njëjtë...

**Arianit Elshani:** Sigurisht, zvogëlimi i pozicioneve nuk është informacion i mirë por, kam propozuar që të punohet me institucioneve, si Kuvendi që të shtyhet ky problem përpara. Dua ti ftoj anëtarët e KQZ-së në grupet tona parlamentare, të lobjojmë për kthimin e atyre pozicioneve. Pra, këto vende pune janë të rëndësishme dhe garantojnë stabilitetin dhe funksionin e rëndësishëm të KQZ-së, sidomos të Sekretariatit...

## 6. Të ndryshme.